



UDHËRRËFYES PËR POLITIKA QË SYNOJNË PARANDALIMIN E BULLIZMIT NË SISTEMIN ARSIMOR NË SHQIPËRI

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe




EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe



Udhërrëfytes për politika që synojnë parandalimin e bullizmit në sistemin arsimor në Shqipëri

DHJETOR 2018

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Përgatitur nga: Maria Golubeva, RHC
Consulting

2018 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çfarëdo sistemi depozitimi ose marrjeje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Botuar në kuadër të Veprimit “Lufta kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në Shqipëri”, të Instrumentit Horizontal të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Lista e shkurtimeve

CDC/ KKD	Kompetencat për Kulturën Demokratike
CoE/KiE	Këshilli i Evropës
CPD/KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
ECRI/KERI	Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
EU/BE	Bashkimi Evropian
HF/IH	Instrumenti Horizontal
MoESY/MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
RED/DAR	Drejtoritë Arsimore Rajonale
SEL /MSE	Të Mësuarit Social dhe Emocional
TOT/TIT	Trajnimi i Trajnerëve
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

Përmbajtja

Udhërrëfyes për Politika që Synojnë Parandalimin e Bullizmit në Sistemin e Arsimit në Shqipëri.....	0
Përmbledhje Ekzekutive	7
Hyrje.....	9
Historiku Seksioni I	11
1.1 Situata aktuale, kuadri ligjor, politikat dhe praktikat në Shqipëri.....	11
Historiku Seksioni II	14
Analiza e praktikave më të mira ndërkombëtare për parandalimin e bullizmit dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës për Shqipërinë	14
2.1 Reagimet e politikës ndaj bullizmit: praktikat ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave të Këshillit të Evropës për Shqipërinë	14
2.2 Rekomandimet e prodhuara në kuadrin e Instrumentit Horizontal të veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës (BE / KE) në Shqipëri.....	18
Historiku Seksioni III	22
3.1 Shembuj të politikave dhe praktikave të mira të prezantuara nga shkollat pilot.....	22
IV Udhërrëfyesi	28
Rekomandime lidhur me kuadrin e politikave për të parandaluar bullizmin dhe promovimin e mjedisit të sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor.....	28
4.1 Politikat në nivel kombëtar	28
4.2 Politikat në nivel komune/bashkie.....	31
4.3 Politikat në nivel shkolle	32
4.4 Masa monitoruese	34

Përmbledhje Ekzekutive

■ Një ambient shkollor i sigurt dhe gjithëpërfshirës është thelbësor. Bullizmi në shkollë ndikon negativisht në shëndetin mendor dhe fizik, si dhe në performancën akademike të fëmijëve. Ky Udhërrëfyes shërben si udhëzues për të garantuar qëndrueshmëri për rezultatet pozitive të projektit të Bashkimit Evropian/ Këshillit të Evropës “Lufta kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në Shqipëri” dhe jep rekomandime për hapa të mëtejshëm të politikave për reduktimin e rrezikut të bullizmit në shkollat shqiptare.

■ Rreth 19,4% e nxënësve shqiptarë kanë qenë pak a shumë sistematikisht objekt i bullizmit. Në të njëjtën kohë, vetëm rreth 23% e mësuesve kanë marrë trajnim lidhur me si mënyrat e trajtimit të bullizmit dhe rreth 45% e nxënësve kanë thënë se mësuesit e tyre nuk kanë ndërhyrë nëse ka pasur raste bullizmi (2017). Për ta reduktuar këtë fenomen të dëmshëm, Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në nenin 18 thotë se Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale duhet të marrin masa për të krijuar mekanizma efikasë për parandalimin, adresimin dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të rasteve të dhunës, përfshirë dhunën mes fëmijëve në shkollë (bullizmin). Strategjia Kombëtare për Edukimin Parauniversitar 2014-2020 trajton çështjet e dhunës dhe bullizmit në shkollë nëpërmjet dy objektivave: (i) ndërtimin e një filozofie gjithëpërfshirëse në shkolla; dhe (ii) krijimin e një mjedisi miqësor në shkolla.

■ Projekti i BE/Këshillit të Evropës u dha mundësi 21 shkollave

pilot të kenë politika kundër bullizmit dhe ekipe të trajnuara në shkolla për të diktuar, parandaluar dhe luftuar bullizmin. Mbështetur nga mentorët e projektit, shkollat hartuan politikat dhe planet e tyre të veprimit, si dhe zbatuan një numër aktivitete kundër bullizmit.

— Udhërrëfyshi rekomandon një varg masash për institucionalizimin e mekanizmave për parandalimin e bullizmit në nivel kombëtar (p.sh. trajnimin e mësuesve, kurrikulat, veprimet që do t'i shtohen Strategjisë Kombëtare të ardhshme përtej vitit 2020). Në të njëjtën kohë, rekomandon që veprimet e mbështetura nga projekti i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës të bëhen të qëndrueshme (përfshirë anën financiare) dhe të shpërndahen edhe në shkolla të tjera në Shqipëri.

Hyrje

— Ky Udhërrëfyes synon të informojë dhe orientojë hartuesit e politikave në sektorin e arsimit në Shqipëri se si t'i përmirësojnë politikat për parandalimin e bullizmit dhe të promovojnë mjedisin e sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor, duke përshkallëzuar përvojat nga 21 shkolla pilot në nivelin e politikave. Në thelb, qëllimi kryesor i Udhërrëfyesit është të sugjerojë si të institucionalizohen mekanizmat për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor në nivelin e kurrikulës, pedagogjisë, vlerësimit, edukimit të mësuesve dhe qasjes në nivel shkollor.

— Dokumenti i udhërrëfyesit:

- > paraqet një analizë të thelluar të legjislacionit ekzistues, dokumentet e politikave arsimore dhe situatën e përgjithshme në shkollat shqiptare lidhur me bullizmin dhe mjedisin shkollor gjithëpërfshirës,
- > identifikon boshllëqet e mundshme në politikën aktuale, dhe
- > bazuar në përvojën e shkollave pilot, propozon një qasje strategjike prioritare për trajtimin e këtyre çështjeve.

— Bullizmi në shkolla është një praktikë e vazhdueshme shqetësuese dhe e dëmshme nga pikëpamja shoqërore dhe psikologjike që prek shumë nxënës. Siç është theksuar në një studim të kohëve të fundit të BE-së, 'Bullizmi në shkollë mund të ndikojë në shëndetin mendor dhe fizik, si dhe në ecurinë akademike të fëmijëve dhe të të rinjve dhe mund të çojë në largim para kohe nga shkolla. Në shumë raste, bullizmi i çon viktimat në vetëvrasje ose në tentativë për vetëvrasje, ankth, depresion dhe vetëlëndim.'ⁱ

— Shpesh, bullizmi ka të bëjë me qëndrime diskriminuese ndaj

nxënësve nga grupet e perceptuara si ‘të ndryshme’, pakicat, romët ose emigrantët. Këto qëndrime e lidhin bullizmin me ekstremizmin e dhunshëm. Sipas UNESCO-s, “pikëpamjet ekstremiste të dhunshme mund të ekspozohen për një sërë çështjesh, përfshirë politikën, fenë dhe marrëdhëniet gjinore”, të cilat manifestohen duke mohuar pikëpamjet e ndryshme, duke mbivlerësuar ekskluzivitetin e mendimit personal, duke refuzuar dallimin, duke mohuar diversitetin dhe duke u treguar të gatshëm për të imponuar mendimin e një njeriu nëpërmjet veprimeve të dhunshme.ⁱⁱ

Që nga viti 2017, Këshilli i Evropës ka zbatuar në Shqipëri projektin “Lufta kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në Shqipëri”, i cili ka prodhuar një numër rekomandimesh mbi masat në nivel vendi dhe shkolle për të parandaluar bullizmin dhe ekstremizmin në shkollat shqiptare (shih më poshtë seksionin 2.2). Ky Udhërrëfyes sugjeron mënyra për të përmirësuar disa prej këtyre rekomandimeve si masa të përhershme të politikave.

Dokumenti i Udhërrëfyesit përfshin sa më poshtë:

- 1.** Historiku Seksioni I: Analizë e rekomandimeve dhe standardeve ndërkombëtare si dokumentet e Këshillit të Evropës për shkollën demokratike dhe Kompetencat për Kulturën Demokratike;
- 2.** Historiku Seksioni II: Analiza e dokumenteve të politikave shqiptare mbi parandalimin e bullizmit dhe situatën aktuale në lidhje me bullizmin dhe politikat gjithëpërfshirëse të shkollës (bazuar në sondazhin kombëtar);
- 3.** Historiku Seksioni III: Diskutimi i ndërhyrjeve për parandalimin e bullizmit dhe promovimin e kulturës gjithëpërfshirëse në shkolla, nga 21 shkollat pilot; dhe
- 4.** Udhërrëfyesi: Rekomandime për politikat e nevojshme për institucionalizimin e mekanizmave për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor në nivel të autoriteteve kombëtare dhe lokale.

Historiku Seksioni I

1.1 Situata aktuale, kuadri ligjor, politikat dhe praktikat në Shqipëri

1.1.1 Bullizmi në shkollat e Shqipërisë

— Sipas sondazhit në nivel kombëtar të kryer në kuadër të këtij projekti të veprimit të përbashkët të BE/KiE “Lufta kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin e Arsimit”, rreth 19,4% e nxënësve shqiptarë kanë qenë objekt i bullizmit ose të përfshirë në të së paku 2 ose 3 herë në muaj.ⁱⁱⁱ Mes tyre, rreth 45% përjetojnë bullizëm psikologjik, 37% janë viktima të bullizmit verbal, kurse 33% kanë përjetuar bullizëm fizik.^{iv} Bullizmi shfaqet në shumë forma – përfshi atë verbale, fizike, psikologjike, sociale, dhe kibernetike.

— Ndërgjegjësimi dhe përgatitja e mësuesve është një faktor kyç, dhe po kështu është gatishmëria e tyre për të ndërhyrë sa herë që ndodh një episod bullizmi. Sipas studimit, 45,5% e nxënësve mendojnë se mësuesit e tyre nuk ndërhyjnë në situatat e bullizmit.^v Vetëm rreth 23% e mësuesve kanë marrë trajnim se si të merren me bullizmin. Shkollat në Shqipëri nuk kanë politika anti-bullizëm.^{iv}

1.1.2 Kuadri kombëtar i politikave^{vii}

— Termi “bullizëm” është njohur ligjërisht në Shqipëri me **Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve**, që e përkufizon bullizmin si dhunë mes fëmijëve. Neni 18 thotë: “Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit marrin masa për ngritjen e mekanizmave efikasë për parandalimin, trajtimin

brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bullizmi).^{viii} Bullizmi konsiderohet nga ligji si një lloj dhune: “dhuna që ndodh mes fëmijëve në shkollë”.

— Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të **Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**. Bazuar në rezultatet e këtij monitorimi, në vitin 2013, KMD-ja i rekomandoi Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASHZ) që të marrë masa për reduktimin e bullizmit në shkolla dhe për të futur edukimin e të drejtave të njeriut në programin shkollor. Për këtë qëllim, KMD-ja nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me MASHZ-në për zhvillimin e materialeve informuese për të drejtat e njeriut dhe anti-diskriminim për shkollat dhe nxori një rekomandim për drejtorët e shkollave mbi masat për të luftuar diskriminimin dhe homofobinë.

— **Ligji për Arsimin Parauniversitar** ofron mbrojtje nga diskriminimi. Ligji ndalon diskriminimin në shkollë në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë etnike, gjuhës, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose sociale, moshës, vendbanimit, aftësive të kufizuara dhe çdo arsye tjetër të përmendur nga legjislati dhe thekson që nxënësit duhet të mbrohen nga çdo formë dhune, dëmtimi ose diskriminimi (neni 6).

— **Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2014-2020** është dokumenti kryesor që përcakton politikën e arsimit në Shqipëri. Strategjia adreson çështjet e dhunës në shkollë nëpërmjet dy objektivave: (i) ndërtimin e një filozofie gjithëpërfshirëse në shkolla; dhe (ii) krijimin e një mjedisi miqësor në shkolla.

— **Plani Kombëtar për Ndalimin e Dhunës në Shkolla dhe Komunitete** është një dokument tjetër politikash me potencial për të kontribuar në reduktimin e bullizmit në të ardhmen.

— **Iniciativat kombëtare** “Shkollat si Qendra Komunitare”, “Ndal Dhunës në Shkollë», «Oficerët e Sigurisë në Shkolla” dhe “Rrjetet

Profesionale të Mësimdhënësve" kanë të gjitha lidhjet potenciale me çështjen e parandalimit dhe reduktimit të bullizmit në shkolla dhe çdo politikë e re anti-bullizmi duhet të integrohet me këto iniciativa. Sugjerimet për mënyra konkrete të integrimit të këtyre iniciativave me politikat anti-bullizëm përmenden në rekomandimet e nivelit kombëtar në këtë Udhërrëfyes.

Historiku Seksioni II

Analiza e praktikave më të mira ndërkombëtare për parandalimin e bullizmit dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës për Shqipërinë

— Ky seksion ofron një përmbledhje të praktikave më të mira ndërkombëtare për parandalimin e bullizmit dhe për nxitjen e kulturës gjithëpërfshirëse në shkolla dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës për Shqipërinë në këtë kontekst.

2.1 Reagimet e politikës ndaj bullizmit: praktikat ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave të Këshillit të Evropës për Shqipërinë

— Organizmat ndërkombëtare si Këshilli i Evropës i kushtojnë shumë vëmendje përpjekjeve të nevojshme për krijimin e një mjedisi demokratik dhe miqësor në shkolla për të mirën e të gjithë shoqërisë. Kuadri Referues i Kompetencave të Kulturës Demokratike (KKD) i Këshillit të Evropës vë theks të veçantë në qasjen në gjithë shkollën, ku përfshihen konceptet kryesore të qeverisjes së shkollës dhe kulturës shkollore:

- > stilin e të drejtuarit të nxitur nga respektimi i të drejtave të njeriut, parimet demokratike, trajtimi i barabartë, vendimmarrja me pjesëmarrje dhe llogaridhënia e përgjegjshme;
- > pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve në rishikimin e mjedisit në

tërë shkollën dhe aftësinë e tij për të promovuar qytetarinë demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

- > strukturat dhe procedurat gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrësen në vendimmarrje, përfshirë kompetencat për mësuesit, nxënësit dhe prindërit në përcaktimin e axhendave dhe pjesëmarrjen në vendimet për politikat;
- > politikat shkollore që reflektojnë vlerat dhe parimet e qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut;
- > rregullat e funksionimit në shkollë që garantojnë trajtim të barabartë dhe akses të barabartë për të gjithë nxënësit, mësuesit dhe anëtarët e tjerë të stafit, pavarësisht nga përkatësia etnike, identiteti kulturor, mënyra e jetesës ose besimet;
- > pjesëmarrjen e nxënësve.^{ix}

■ Një numër politikash kombëtare në nivel shkolle dhe qasje pedagogjike vlerësohen nga ekspertët ndërkombëtarisht si efikase për të luftuar bullizmin dhe kanë rezultuar se reduktojnë faktorët që çojnë drejt tij.

■ Disa (por jo të gjitha) nga këto politika dhe masa renditen më poshtë:

- **Qasja në nivel shkolle** për trajtimin e bullizmit si një problem sistematik:^x Qasja efikase në tërë shkollën përfshin të gjithë stafin e shkollës dhe nxënësit dhe një numër politikash dhe masash të rëndësishme që lidhen me reduktimin e bullizmit. Masat efikase përfshijnë trajnimin/takimet me prindërit, trajnimin e specializuar të mësuesve, mbikëqyrjen e shesheve sportive dhe palestrave, rritjen e ndërjegjësismit, si video rreth pasojave të bullizmit, metodat disiplinore jondëshkuese ose qasje me tolerancë zero, punë në grupe bashkëpunuese mes profesionistëve, rregullat për menaxhimin e duhur të klasës. Të gjitha këto duhet të mbështeten nga një politikë anti-bullizëm në nivel shkolle.^{xi}

Një numër qasjesh në nivel shkolle kanë rezultuar efikase dhe të transferueshme në një kontekst tjetër kombëtar.

- **Kombinimi i masave universale që synojnë të gjithë nxënësit** për parandalimin dhe **masat e specifikuara** për personat e përfshirë në adresimin e rasteve të **bullizmit**. Një shembull i kësaj qasjeje është modeli KiVa (Finlandë). Programi anti-bullizëm i zhvilluar nga Universiteti i Turku-së kombinon *masat universale dhe masat e specifikuara*: masat universale shënjestrojnë të gjithë nxënësit dhe e kanë parandalimin e bullizmit si qëllim kryesor. Masat e specifikuara shënjestrojnë fëmijët që janë bërë autorë të veprave penale dhe viktimat të një rasti bullizmi dhe sfidojnë disa nxënës të tjerë nga e njëjta klasë për të mbështetur viktimën. Efektiviteti i programit KiVa njihet ndërkombëtarisht përmes një numri studimesh.^{xii} Programi KiVa përdoret në disa vende në Evropë dhe po konsiderohet për zbatim në SHBA. Megjithatë, kritikët theksojnë se 'nga perspektiva e mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve, është përsëri problematike që një sistem reagimi mbështetet në mënyrë qendrore në reagimet dhe përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve të tjerë.'^{xiii}
- Një formë e qasjes në nivel shkolle që ka fituar shumë vëmendje ndërkombëtare është Programi i Parandalimit të Bullizmit Olweus, i cili përfshin komponentët në katër nivele: nivel shkolle, nivel klase, nivel individual dhe nivel komuniteti.^{xiv} Kjo qasje përfshin një numër masash të përgjithshme për të gjithë shkollën dhe i kushton vëmendje të veçantë nxënësve që janë përfshirë në bullizëm ose janë viktimat të bullizmit.
- **Qasja kurrikulare në edukimin social dhe emocional:** Të mësuarit social dhe emocional (MSE) bazohet në qasje kurrikulare dhe pedagogjike që theksojnë "vetëdijen ndaj emocioneve, mirësjelljen, empatinë dhe shqetësimin për të tjerët, marrëdhëniet pozitive, marrjen e vendimeve të përgjegjshme, kontrollin impuls, zgjidhjen e konfliktit në

mënyrë konstruktive dhe vlerësimin e mendimeve, ndjenjave dhe zërit të nxënësve.^{xv} Për të zbatuar këtë qasje, kurrikula rishikohet për të futur MSE-në si një modul ose si një seri elementesh të futura në kontekstin e lëndëve të tjera (p.sh. kontekstin e shkencave sociale / studimeve sociale.

— Organizatat ndërkombëtare si Këshilli i Evropës dhe UNESCO i kushtojnë shumë vëmendje promovimit të politikave dhe praktikave që parandalojnë bullizmin. Për vite me radhë, organizmat e Këshillit të Evropës kanë zhvilluar një numër rekomandimesh për reduktimin e bullizmit në Shqipëri.

— Raportet e organizmave monitoruese të Këshillit të Evropës: Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Mostolerancës (2015) dhe Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (2011) i rekomandojnë Shqipërisë të ndërmarrë masa specifike kundër diskriminimit në shkolla dhe të miratojë masa ndërgjegjësimi mbi çështjet e tolerancës dhe anti-diskriminimit që synojnë trajnimin e mësuesve dhe informimin e publikut.

— Në maj të vitit 2018, Komisionerja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Dunja Mijatovi, gjatë vizitës së saj në Shqipëri bëri një referencë të qartë ndaj nevojës për të vazhduar trajtimin për bullizmin e ndërsjelltë (mes shokëve/moshatarëve) në shkolla. Komisionerja gjithashtu i inkurajoi autoritetet që të vazhdojnë ta trajtojnë bullizmin dhe ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e profesionistëve të arsimit për të parandaluar dhunën.^{xvi}

— Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (KERI) rekomandon që autoritetet të *përbushin detyrën ligjore për të luftuar diskriminimin në shkolla dhe për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtën për trajtim të barabartë, diversitet, kundër diskriminimit dhe bullizmit në shkolla. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit të mësuesve.*^{xvii}

2.2 Rekomandimet e prodhuara në kuadrin e Instrumentit Horizontal të veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës (BE / KE) në Shqipëri

— Veprimi i përbashkët i Instrumentit Horizontal të Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës (këtu enë vijim veprimi i përbashkët i BE-së dhe Këshillit të Evropës), “Lufta kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimit në Shqipëri”, prodhoi një numër rekomandimesh në nivel kombëtar dhe në nivel shkollë për masat që parandalojnë bullizmin dhe ekstremizmin radikal në shkollat shqiptare. Një përmbledhje e politikës e bërë me porosi të Këshillit të Evropës (2017) rekomandon që të krijohet një kuadër i qartë politikash për trajtimin e dhunës dhe ekstremizmit në shkolla në nivel të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke u kërkuar dhe mbështetur shkollat për të zhvilluar dhe zbatuar politikat anti-bullizëm. Politika të tilla duhet të përfshijnë gjithashtu masa për të adresuar rreziqet nga pikëpamjet ekstremiste dhe përhapjen e historive mes nxënësve.

— Masat në nivel kombëtar të rekomanduara në këtë përmbledhje të politikave^{xviii} përfshijnë:

- Një program kombëtar për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për shkollat për të parandaluar bullizmin dhe sjelljen diskriminuese. Një program i tillë duhet të mbështesë një qasje në nivel shkollë me theks në zhvillimin e shkathtësive dhe kompetencave të stafit të shkollave përmes trajnimit dhe mentorimit, duke përfshirë një element të fortë të reagimeve dhe të mësuarit në grup;
- Përmirësimi i kurrikulës kombëtare me qëllim përcaktimin e shkallës së adresimit të nevojës për të mësuarit/edukimin social dhe emocional (MSE) dhe për edukimin e mendimit kritik, të nevojshme për të parandaluar bullizmin dhe ekstremizmin;
- Rritja e ndërgjegjësimit të mësuesve, nxënësve dhe komu-

nitetit ndaj manifestimeve të bullizmit dhe ekstremizmit, siç është gjuha e urrejtjes dhe sigurimi i tyre me një repertor të qasjeve / resurseve të kurrikulës për të luftuar ekstremizmin, si në shkollë, dhe në komunitet.

■ Masat në nivel shkolle të rekomanduara në këtë udhëzim përfshijnë:

- Miratimi i politikave shkollore kundër bullizmit, përfshirë rregulla të përcaktuara qartë, përkufizime dhe udhëzime për identifikimin e sjelljeve të bullizmit dhe për masat që duhet të ndërmerren për parandalimin e bullizmit dhe për trajtimin e rasteve të bullizmit nëse ato ndodhin;
- Futja e një grupi të fortë të masave universale (në nivel shkolle) që synojnë të gjithë nxënësit (parandalimin) dhe një grup po aq të fortë masash të specifikuar për nxënësit e përfshirë në bullizëm;
- Politikat e shkollës që rrisin kulturën demokratike të shkollës;
- Masat për të siguruar që shkolla të jetë e sigurt për të gjithë nxënësit (klasat, ambientet sportive, etj);
- Krijimi i një strategjie në nivel komuniteti për të parandaluar dhe reduktuar bullizmin;
- Gjithmonë të adresohen rastet e ekstremizmit dhe gjuhës së urrejtjes.

■ Konferenca Ndërkombëtare e Durrësit për Bullizmin dhe Ekstremizmin në Shkollë organizuar nga Veprimi i IH të BE/KiE në qershor të vitit 2017, përfundoi me rekomandimet e mëposhtme për luftimin e bullizmit dhe ekstremizmit në shkollat e Shqipërisë:

Nivel politike:

- > Monitorimi dhe sigurimi i zbatimit të ligjeve & konventave tashmë në fuqi (përgjegjësi jo vetëm e Ministrisë së Arsimit), por në nivel më të gjerë politik dhe social.
- > Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve dhe konventave.
- > Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive të qarta për luftimin e bullizmit dhe ekstremizmit.
- > Nxjerrja e mësimëve nga eksperiencia e shkollës pilot dhe reflektimi i tyre në politikë dhe praktikë.
- > Hartimi i udhëzimeve dhe manualeve për stafin e shkollës (mësuesit, drejtorët e shkollave dhe stafi mbështetës) për t'i ndihmuar ata të identifikojnë dhe të trajtojnë bullizmin, ndërkohë që krijojnë besim në dhënien, raportimin dhe kuptimin e bullizmit dhe ekstremizmit.
- > Sigurimi i trajnimit të mësimdhënësve për temën (para shërbimit dhe në shërbim) dhe rifreskimi e përditësimi i këtij trajnimi.
- > Mbështetja e shërbimeve sociale dhe psiko-sociale në nivel shkolle dhe komuniteti (kjo mund të kërkojë rritje të buxhetit në mënyrë që ata të mund të ofrojnë shërbimin e tyre në të gjitha shkollat).
- > Përfshirja e “temave të bullizmit dhe ekstremizmit” në kurrikula (edukimi qytetar).
- > Përsëritni rregullisht sondazhin në nivel vendi (kombëtar) për të siguruar që aktorët e arsimit të jenë të informuar mirë për nevojën dhe po vlerësojnë rregullisht ofrimin e shërbimeve për të luftuar bullizmin dhe ekstremizmin.

Nivel shkolle (parandalimi, ndërhyrja dhe monitorimi)

> Vetëvlerësimi i shkollave është i domosdoshëm për të vlerësuar se ku janë shkollat në kuptimin e identifikimit të nevojave të tyre dhe trajtimit për çështje të tilla si bullizmi dhe ekstremizmi dhe se si shkollat dhe organizatat e tjera, përfshirë komunitetet dhe hartuesit e politikave, mund të mbështesin njëri-tjetrin në mënyrë kolektive.

■ Në 1.5 vitet që kanë kaluar që nga konferenca e Durrësit, disa përmirësime janë arritur në saje të aktiviteteve të Këshillit të Evropës dhe të shkollave pilot. Ky Udhërrëfyes bën rekomandime të mëtejshme bazuar në mësimet e nxjerra nga këto përpjekje.

Historiku Seksioni III

3.1 Shembuj të politikave dhe praktikave të mira të futura nga shkollat pilot


3.1.1. Politikat shkollore për të parandaluar bullizmin

■ Në kuadër të projektit “Luftimi i Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në Shqipëri”, 21 shkolla pilot kanë zhvilluar dhe kanë nisur politikat dhe praktikat kundër bullizmit

■ Ekipet anti-bullizëm të shkollave kanë zhvilluar politikat e tyre në mënyrë pjesëmarrëse, në bashkëpunim me ekspertët e përzgjedhur nga veprimi i përbashkët i IH të BE/KiE. Ekipet e shkollave zhvilluan dhe zbatuan politikat dhe praktikat e reja në baza vullnetare, me mbështetjen e veprimit të përbashkët të IH të BE / KiE dhe me pëlqimin (dhe nganjëherë mbështetjen) nga drejtoritë rajonale të arsimit.

■ Figura 1 më poshtë përshkruan elementet minimale thelbësore të një politike të mirë shkollore për parandalimin e bullizmit dhe ekstremizmit, meshembujtë masave konkrete që duhet të përfshihen në Planin e Veprimit të shkollës për Parandalimin e Bullizmit.

Figura 1. Skicë e një politike të shkollës dhe planit të veprimit



— Politikat e reja të shkollave në një numër rastesh kombinojnë si masat universale (duke synuar të gjithë shkollën dhe komunitetin) dhe masat e specifikuar (masa që angazhojnë fëmijët e përfshirë në episode të bullizmit).

— Masat **universale** të përshkruara në një numër politikash shkollore përfshijnë (por nuk kufizohen me):

1. Masat që angazhojnë nxënësit dhe prindërit së bashku me personelin e shkollës në zhvillimin e rregullave të klasës dhe hapave të tjerë për parandalimin e bullizmit, si p.sh.:

- > Përfshirja e nxënësve dhe prindërve në vendosjen e rregullave në klasë kundër bullizmit dhe hapave që duhet të ndërmerren në rast se ndodh;
- > Diskutoni, krijoni dhe komunikoni pritshmëritë për nxënësit, prindërit, stafin e shkollës, stafin mbështetës, drejtorët/kujdestarët e konvikteve dhe shoferët e autobusëve të shkollës.

2. Masat për krijimin e një sistemi të përgjegjësive së përbashkët, raportimit dhe ndjekjes së incidenteve, p.sh.:

- > **Ngritja e ekipit anti-bullizëm** të shkollës (nga mësuesit, përfshirë aty ku është e mundshme drejtori i shkollës, përfaqësuesit e prindërve dhe anëtarët e personelit jo-mësimdhënës);
- > Krijimi dhe komunikimi i një sistemi të qartë të regjistrimit të incidenteve të bullizmit (një regjistër ku të regjistrohen dhe ndiqen rastet e bullizmit, një format i unifikuar për të raportuar çdo rast, një bazë të dhënash për të gjitha rastet, përfshirë ndjekjen nga anëtarët përgjegjës të ekipit anti-bullizëm) garantimit se i gjithë informacioni ruhet gjithashtu në formatin online;
- > Sigurohuni që të ketë një ekip / komision funksional me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të shkollës (mësues, nxënës, prind, psikolog, drejtor). Bëni përdorimin e duhur të Komisionit të Disiplinës dhe Etikës për të vendosur procedurat se si të adresohen rastet e bullizmit. Sigurohuni që rolet të përcaktohen dhe të njihen nga të gjithë anëtarët e Komitetit / ekipit.
- > Hartoni udhëzimet ose manualet për stafin e shkollës (mësuesit dhe stafi mbështetës) për t'i ndihmuar ata të identifikojnë dhe të luftojnë bullizmin. Udhëzimet e tilla duhet të hartohen nga ekipi anti-bullizëm në bazë të diskutimeve, jo nga administrata e shkollës ose vetëm nga drejtori.

3. Masat që sigurojnë se në mjedisin shkollor nuk ka dhunë, përmes monitorimit dhe mbikëqyrjes:

- > Monitorimi i rregullt i klasave të shkollës, korridoreve dhe ambienteve nga mësuesit që veprojnë si mbikëqyrës gjatë ditës në shkollë;

- > Vendosja e oficerëve të sigurisë në shkolla dhe lidhja e tyre me ekipin e anti-bullizmit të shkollës;
- > Monitorimi i të ashtuquajturave pikat e nxehta (vendet me rrezik më të lartë për bullizëm) në shkollë (p.sh. mësuesit e sporteve janë të angazhuar për monitorimin e palestrës dhe oborrit) dhe jashtë (transportimi brenda dhe jashtë shkollës);
- > Përcaktimi në cilat vende dhe mjedise (p.sh. aktivitetet online) dhe gjatë cilave periudha (p.sh. gjatë praktikave, ekskursioneve shkollore, aktiviteteve jashtëshkollore) rreziku i bullizmit është më i lartë dhe kështu nevojitet vëmendje dhe mbikëqyrje.

4. Masat që rrisin ndërgjegjësimin ndaj fenomenit të bullizmit dhe pasojat e tij negative:

- > Organizimi i aktiviteteve shkollore për të informuar dhe rritur ndërgjegjësimin kundër bullizmit (edhe në nivel komuniteti). Bërja e planit të aktiviteteve të dukshëm në korridoret e shkollës dhe në çdo klasë. Bërja e politikës anti-bullizëm të njohur në Bordin e Prindërve, Vetëqeverisjen e Nxënësve, dhe në stafin mësimdhënës dhe jo mësimdhënës.
- > Komunikimi i një kujtese për atë që NUK ËSHTË bullizëm (p.sh. reagime konstruktive dhe objektive mbi performancën ose sjelljen e dikujt nga një anëtar i stafit të shkollës ose kolegëve);
- > Organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore si shfaqja e filmave ose vendosja e një shfaqjeje teatrore me temë bullizmin dhe diskutimi me nxënësit më pas.

Masat e specifikuara(të synuara) përfshijnë (por nuk kufizohen me):

- 1. Ofrimi i këshillimit si për viktimat e bullizmit, dhe për bulistët.** Kjo masë duhet të trajtohet me profesionalizëm dhe kujdes, duke përfshijë mundësisht psikologun e shkollës ose punonjësin social (nëse shkolla nuk ka personel të kualifikuar, është e rëndësishme që specialistët e kualifikuar të ofrohen nga Drejtoria Rajonale e Arsimit ose institucione të tjera të komunitetit lokal). Trajtimi thjesht administrativ / ndëshkues i rasteve të bullizmit nga administrata e shkollës ka të ngjarë të ketë efekt negativ.
- 2. Garantimi i sigurisë për viktimat e bullizmit;**
- 3. Angazhimi i bulistëve dhe viktimave të bullizmit në aktivitetet jashtëshkollore** (nën mbikëqyrjen e mësuesve). Përsëri, kjo masë ka të ngjarë të jetë më efektive kur është projektuar me ndihmën e psikologut të shkollës ose profesionistëve të tjerë.

3.1.2 Masat e propozuara në plan-veprimet e shkollave

— Bazuar në këto dhe politika të ngjashme të zhvilluara nga shkollat, u krijuan planet e veprimit në shkolla. duke treguar një numër masash që duhet të zbatohen menjëherë nga shkollat.

— Masat e propozuara përfshijnë një numër aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit, p.sh.

- > Përmbliidni procedurat e ndërhyrjes për të rriturit. Bëjini ata të vetëdijshëm për listën e treguesve indirekt të mundshëm në rast bullizmi (fëmija fillon të belbëzoj, qan gjatë natës, kthehet në shtëpi me rroba të grisura, vjedh paratë, bëhet nervoz kur merr një mesazh telefonik etj);

- > Ftoni prindërit të bashkëpunojnë me shkollën për masat anti-bullizëm;
- > Kërkojini stafit të shkollës që të mos injorojnë rastet e bullizmit;
- > Organizoni një fushatë ndërgjegjësimit me nxënësit dhe komunitetin kundër bullizmit.

■ Në mënyrë që planet e veprimit të jenë efektive, ata duhet të specifikojnë kohën dhe numrin e aktiviteteve, si dhe kush është përgjegjës dhe cili duhet të jetë rezultati i planifikuar.

■ Këtu janë disa shembuj të aktiviteteve për planin e veprimit anti-bullizëm që mund të jenë të dobishme:

Shembuj të aktiviteteve për planin e veprimit

- > Organizoni tre aktivitete ndërgjegjësuese për bullizmin dhe pasojat e tij për grupmoshat e ndryshme të nxënësve në fund të vitit shkollor. Përgjegjës: koordinatori i ekipit anti-bullizëm në shkollë dhe tre mësues të klasave.
- > Përcaktoni procedurat për raportimin dhe trajtimin e bullizmit (me datën në të cilën duhet të funksionojë mekanizmi). Përgjegjës: drejtori i shkollës dhe koordinatori i ekipit të shkollës kundër bullizmit.
- > Hartoni udhëzime ose manuale për stafin e shkollës (mësuesit dhe stafi mbështetës) për t'i ndihmuar ata të identifikojnë dhe të trajtojnë bullizmin (deri në fund të semestrit të parë). Përgjegjës: ekipi anti-bullizëm i shkollës.
- > Trajtoni vullnetarët si anëtarë të ekipit anti-bullizëm. Përgjegjës: mësimdhënës nga ekipi anti-bullizëm i shkollës që ka marrë pjesë në trajnimin e trajnerëve (TIT) dhe udhëheqësi i vetëqeverisjes së nxënësve.

IV Udhërrëfytyesi

Rekomandime për kuadrin e politikave për të parandaluar bullizmin dhe promovuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor

■ Siç e theksuam më sipër, duhet të krijohet një kuadër i përmirësuar politikash për parandalimin e bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla në nivelin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke kërkuar dhe mbështetur shkollat për të zhvilluar dhe zbatuar politikatat dhe praktikatat anti-bullizëm.

■ Përmes një kuadri të tillë, politikatat dhe masat e zhvilluara nga shkollat pilot mund të bëhen të qëndrueshme dhe të shpërndahen në të gjithë sistemin shkollor shqiptar.

■ Kuadri i propozuar i politikave ka tre nivele:

- > Politikatat në nivel kombëtar (ndryshimet në strategjitë ekzistuese ose të hartuara, integrimi i masave të reja në nismat ekzistuese të politikave dhe në udhëzimet vjetore të Ministrisë për shkollat);
- > Politikatat në nivel komune/bashkie (mbështetje për shkollat për të zhvilluar dhe zbatuar politikatat anti-bullizëm, të organizuara në nivel komunal);
- > Politikatat në nivel shkolle.

4.1 Politikatat në nivel kombëtar

■ Në mënyrë që të institucionalizohen mekanizmat për parandalimin e bullizmit në nivelin e politikës kombëtare, është e

rëndësishme të lidhet futja e masave të reja në politika kombëtare të shkollës së lartë. Meqenëse përfshirja e grupeve të reja të masave në **Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2014-2020** nuk ka gjasa, është e nevojshme të ndahen masat në nivel kombëtar në dy faza:

i. Masat prioritare për vitet 2018-2020

■ Në periudhën e ndërmjetme përpara zhvillimit të një strategjie të re kombëtare për arsimin parauniversitar, është e rëndësishme që:

- 1.1** Të përfundojë pilotimi i politikave dhe planeve të veprimit anti-bullizëm në nivel shkolle dhe dokumentimi i shembujve të politikave dhe masave më efektive (përpjekja e parë në një dokument të tillë, në formë të shkurtër, është marrë nga Seksioni III i këtij Udhërrëfyesi).
- 1.2** Për të siguruar qëndrueshmërinë, gjeni burime kombëtare ose rajonale të financimit për vazhdimin e **programit anti-bullizëm të Këshillit të Evropës me mentorim** në formën e tanishme, të zgjeruara nga mësimet e nxjerra gjatë Vitit 1. U desh një vit që shkollat pilot të zhvillonin politikat dhe praktikat anti-bullizëm dhe ato ende duhet të mësojnë nga kjo përvojë dhe të bëjnë përmirësime. Pritshmëria e shkollave të tjera për ta zbatuar këtë program më vete, me vetëm mbështetje / trajnim metodologjik të trajnerëve dhe pa mentorë, është jorealiste.
- 1.3** Institucionalizimi i politikave anti-bullizëm në nivel shkolle duke kërkuar praninë e politikave anti-bullizëm në çdo shkollë. Kjo mund të bëhet përmes përfshirjes së politikave të shkollës kundër **bullizmit mes prioriteteve të nivelit të lartë në udhëzimin vjetor të dërguar nga Ministria në të gjitha shkollat**, në mënyrë të ngjashme me vitin shkollor 2018/2019, gjithashtu në vitet shkollore 2019/2020 dhe 2010/2021.

Kjo masë mund të përforcohet më tej duke shpërndarë shembujt e politikave të suksesshme shkollore përmes dy lloj aktivitetesh:

1.3.1 Eventet e të mësuarit të ndërsjelltë në shkollat pilot, duke futur politika të reja shkollore në shkollat e tjera që nuk kanë marrë pjesë në projekt. Për të lehtësuar procesin e të mësuarit të ndërsjelltë, ekipet e shkollave pilot duhet të përgatisin fletëpalosje të shkurtra mbi politikat dhe praktikat e reja anti-bullizëm bazuar në *Udhëzuesin e temave në Aneksin 1*.

1.3.2 Moduli i trajnimit të mësuesve bazuar në trajnimin gjatë projektit të shkollës verore. Moduli i trajnimit të mësuesve ishte një element i suksesshëm i projektit dhe më pas është certifikuar si një modul trajnimi për mësuesit në Shqipëri. Trajnimi kaskadë (2 anëtarë të ekipit të trajnuar gjatë trajnimit të trajnerëve (TIT) trajnuan mësues të tjerë në shkollën e tyre) provoi se ishte një model i suksesshëm. Moduli i trajnimit duhet të shpërndahet më tej, ndoshta nga ata pjesëmarrës të ekipeve pilot të cilët kanë kaluar TIT-në, të cilët në të ardhmen mund ta ofrojnë këtë modul ose nëpërmjet Institutit të Zhvillimit të Arsimit ose përmes Rrjeteve Profesionale të Mësimdhënësve. Ky trajnim duhet të mbështetet financiarisht në nivel kombëtar.

— **Integrimi i masave anti-bullizëm me iniciativat kombëtare** “Shkollat si Qendra Komunitare”, “Ndal Dhunës në Shkollë”, “Oficerët e Sigurisë në Shkolla” dhe “Rrjetet Profesionale të Mësimdhënësve” është pjesë e masave prioritare në këtë fazë. Të katër iniciativat kanë lidhje potenciale me çështjen e parandalimit dhe reduktimit të bullizmit në shkolla, dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre duhet të informohen për praktikat më të mira të identifikuara në Seksionin Historiku III të këtij dokumenti dhe duhet të familjarizohen me shpërndarjen e materialeve të projektit.

ii. Masat prioritare për vitin 2021 e në vazhdim

Mënyra më e mirë për të promovuar ndryshimet e politikave në nivel sistemi është krijimi i një kuadri politikash për të, dhe promovimi i zbatimit të tij përmes rregullimit, shpërndarjes dhe sigurimit të burimeve të duhura për zbatimin. Në mënyrë që të arrihet një shkallë e plotë e politikës anti-bullizëm në nivel kombëtar, masat anti-bullizëm duhet të përfshihen në strategjinë e ardhshme kombëtare:

1.4 Strategjia kombëtare për arsimin parauniversitar nga viti 2021 e në vijim duhet të ketë një seksion mbi Shkollën Gjithëpërfshirëse e cila duhet të përfshijë masa specifike të politikave për të parandaluar bullizmin dhe për të siguruar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës shkollor. Ky seksion duhet të shkruhet me pjesëmarrjen e ekspertëve të projektit të Këshillit të Evropës.

Praktikat më të mira nga ky projekt (në formën e politikave efektive të shkollës) duhet të përfshihen në këtë seksion, duke u fokusuar në krijimin e mjedisit miqësor dhe gjithëpërfshirës në shkolla.

iii. Masa shtesë që duhet të konsiderohen

1.5 Rritja e pranisë së të mësuarit socio-emocional (MSE) në kurrikulë do të ishte e dëshirueshme. Kjo mund të arrihet duke futur një modul MSE në programin mësimor të ciklit të ulët të shkollës së mesme dhe mundësisht duke e përfshirë atë në programin e edukimit qytetar, me ndihmën e ekspertëve dhe Institutit për Zhvillimin e Arsimit.

4.2 Politikat në nivel komune/bashkie

■ Bashkëpunim më i mirë ndërmjet Ministrisë, autoriteteve rajonale të arsimit (për shkak të ndryshimeve që do të ndodhin në Drejtorinë Rajonale të Arsimit) dhe shkollave është i nevojshëm

për t'u siguruar që zbatimi i masave anti-bullizëm koordinohet me aktivitete të tjera, p.sh. brenda iniciativave kombëtare për sigurinë në shkolla.

1.6 Drejtoritë rajonale të arsimit mund të luajnë një rol vendimtar në shpërndarjen e praktikave të mira nga shkollat pilot në shkolla të tjera në të njëjtën zonë, p.sh. duke organizuar **evente** të të nxëniet të ndërsjelltë, duke mbështetur shkëmbimin e përvojave dhe duke rritur kapacitetin dhe ekspertizën e tyre për të mbështetur shkollat në zhvillimin dhe zbatimin e masave anti-bullizëm.

1.7 Hapësira të aksesueshme dhe të sigurta për aktivitete të përbashkëta rekreative janë të rëndësishme në promovimin e një mjedisi pa bullizëm. Strukturat e arsimit lokal / rajonal duhet të mbështesin krijimin e ambientit rekreativ për nxënësit në institucionet arsimore, përfshirë hapësirat e aksesueshme për sport dhe aktivitete artistike.

4.3 Politikat në nivel shkolle

■ Në mënyrë që shkollat të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe të zbatojnë politikat e tyre anti-bullizëm, është e rëndësishme që të krijohen strukturat themelore administrative për implementim.

1.8 Veprimi i përbashkët i BE / KiE rekomandon, së paku, krijimin e **strukturave themelore dhe mekanizmave** në vijim në çdo shkollë:

- > Strukturat për trajtimin e bullizmit brenda shkollës: ekipi anti-bullizëm, komiteti i etikës dhe mekanizmi për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të bullizmit. Pikat kryesore të renditura në Historiku Seksioni III i këtij dokumenti mund të shërbejnë si një udhëzues bazë për krijimin e një mekanizmi të tillë në çdo shkollë.

- > Caktimi i udhëheqësit të ekipit anti-bullizëm, në mënyrë që e gjithë shkolla të dijë se kush është udhëheqësi përgjegjës për aktivitetet anti-bullizëm dhe procedurat përkatëse. Ky nuk duhet të jetë drejtori apo nënkryetari i shkollës, por çdo anëtar përgjegjës i ekipit anti-bullizëm që besohet nga komuniteti i shkollës;
- > Politika dhe Plani i Veprimit për të parandaluar bullizmin dhe për të përmirësuar klimën në shkollë duhet të zhvillohen dhe të zbatohen në frymën e punës ekipore dhe të udhëheqjes së përbashkët. Procesi i zhvillimit të politikës shkollë duhet të jetë pjesëmarrës, të ngrejë temën e re të zhvillimit të politikave me prindërit, vetëqeverisjen e nxënësve, stafin jo mësimdhënës dhe mësuesit, duke u kërkuar atyre rekomandime për të përmirësuar draftin fillestar të politikave të hartuara nga ekipi anti-bullizëm.

1.9 Me qëllim përfshirjen e mëtejshme të aktiviteteve anti-bullizëm në planifikimin e shkollës dhe t'i bëjë ato të detyrueshme, Plani i Veprimit për Parandalimin e Bullizmit mund të bëhet pjesë e Planit Afatmesëm (4 vjeçar) që çdo shkollë në Shqipëri duhet të hartojë.

Ministria do të duhet të nxjerrë një udhëzues për të përfshirë politikën dhe aktivitetet anti-bullizëm në Planet Afat-Mesme. Kapaciteti i shkollës për të hartuar plane dhe politika efektive të veprimit duhet të përmirësohet përmes trajnimit dhe mentorimit, duke përdorur burimet e zhvilluara gjatë projektit të Këshillit të Evropës.

1.9.1 Trajnimi i mësimdhënësve për parandalimin e bullizmit, duke përdorur **modulin** e zhvilluar gjatë projektit, duhet të bëhet në çdo shkollë. Sipas ekspertëve të projektit dhe anëtarëve të ekipeve anti-bullizëm, trajnimi duhet të ndihmojë mësuesit dhe anëtarët e tjerë të stafit për të zhvilluar vetëdijen për atë që është / nuk është bullizëm dhe për të ndihmuar shkollën të zhvillojë një përgjigje

më të unifikuar, në mënyrë që të gjithë aktorët në shkollë të jenë të vetëdijshëm se si të reagojnë ndaj rasteve të bullizmit dhe çfarë procedura të ndjekin.

1.9.2 Përmirësimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave për të zhvilluar politikat në nivel shkolle dhe për të planifikuar parandalimin dhe eliminimin e bullizmit në shkolla. Kjo mund të arrihet duke përfshirë materialet e prodhuara nga projekti në një program trajnimi për drejtorët e shkollave.

1.9.3 Plani i Veprimit për Parandalimin e Bullizmit duhet të përfshijë qasjen në nivel shkolle, kur i gjithë personeli, duke përfshirë mësuesit, administratën, personelin jo mësimdhënës dhe oficerët e sigurisë, janë njohur me planin e veprimit dhe mbështesin zbatimin e tij.

1.10 Masat drejtuar për të promovuar një kulturë gjithëpërfshirëse dhe demokratike në shkollë nuk duhet të kufizohen në politikat kundër bullizmit. Masat që nxisin kulturën gjithëpërfshirëse të shkollës dhe mosdiskriminimin, si dhe masat për promovimin e kulturës demokratike në shkollë (bazuar në dokumentet e Këshillit të Evropës si manuali mbi Qeverisjen Demokratike të Shkollave^{xix}) krijojnë sfondin e nevojshëm që masat anti-bullizëm të jenë të suksesshme.

4.4 Masa monitoruese

■ Meqenëse politikat anti-bullizëm aktualisht nuk janë pjesë e ndonjë strategjie kombëtare, është e rëndësishme të merren masa të përkohshme monitorimi deri në momentin kur masat anti-bullizëm të bëhen pjesë e strategjisë së re kombëtare për arsimin parauniversitar. Komiteti Drejtues i projektit të Këshillit të Evropës mund t'i drejtohet Ministrisë për të krijuar një komision të përkohshëm monitorimi që do të prodhojë një raport vjetor mbi promovimin e politikave kundër bullizmit.

Shënim për mbështetjen e politikave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

■ Në vijim të projektit “Luftë kundër Bullizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në Shqipëri”, udhëzimi nr. 27 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin shkollor 2018 - 2019, Kapitulli V “Aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore, vetëvlerësimi” kërkon zbatimin e projektit me prioritet ku ndër të tjera në pikën 3 / d kërkohet angazhimi i grupit të mësimdhënësve të trajnuar në luftën kundër bullizmit në ndarjen e njohurive dhe përvojës së tyre me shkollat e tjera.

Konkluzione

— Rezultati përfundimtar i zbatimit të suksesshëm të politikave anti-bullizëm në nivel kombëtar, komunal dhe shkollor duhet të jetë jo vetëm një reduktim shumë i rëndësishëm i numrit të rasteve të bullizmit, por edhe një mjedis më gjithëpërfshirës, i sigurt dhe miqësor në shkolla.

— Shkollat duhet të mbështeten për të krijuar dhe mbajtur politikat anti-bullizëm, duke përfshirë elemente të tilla si synime dhe objektiva të matshme, lidhje me misionin dhe vizionin e shkollës, ndryshimet përkatëse në rregullat e shkollës dhe klasës, ndarjen e duhur të përgjegjësisë për zbatimin dhe mekanizmin e monitorimit dhe raportimit, përfshirë lidhjet për informimin e prindërve dhe mësuesve të klasave. Masat e politikave duhet të jenë si universale (rritja e ndërgjegjësimit ndaj bullizmit dhe pasojat e tij) dhe të specifikuar (adresimi i rasteve konkrete të bullizmit) dhe duhet të bazohen në një qasje në nivel shkolle.

— Vazhdimi i programit anti-bullizëm i Këshillit të Evropës me mentorimin në formën e tij aktuale është thelbësor për shpërndarjen e politikave dhe praktikave përkatëse në shkollat e tjera në Shqipëri, duke rritur në të njëjtën kohë kapacitetin e tyre për të zhvilluar dhe zbatuar politikat e shkollës së tyre. Kjo do të ketë një ndikim të qëndrueshëm pozitiv mbi kapacitetin e përgjithshëm të shkollave për të zhvilluar dhe zbatuar politika edhe në fusha të tjera.

— Mbështetja e autoriteteve kombëtare është e nevojshme për t'u mundësuar shkollave të përfitojnë nga parakushtet thelbësore të kësaj qasjeje: trajnimi i mësuesve për parandalimin e bullizmit, masat për rritjen e kapacitetit të drejtorëve të shkollave për të

zhvilluar politika në nivel shkolle dhe mbështetja për zhvillimin e Plan-Veprimeve të qëndrueshme dhe efektive.

■ Asnjëra nga këto më sipër nuk është shumë e vështirë ose kërkon burime të gjera - ky është rasti kur ndërhyrjet e politikave të projektuara mirë me investime relativisht të pakta mund të arrijnë rezultate pozitive në shkolla, siç po fillojnë të demonstrojnë shkollat pilot të projektit të Këshillit të Evropës.

Shënime

- i Downes P., Cefai, C. (2016) Si të Parandalojmë dhe të Trajtojmë Bullizmin dhe Dhunën në Shkolla: Dëshmi dhe Praktika për Strategjitë për Shkolla Gjithëpërfshirëse dhe të Sigurta, Raporti i NESET II, Luksemburg: Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian.
- ii UNESCO (2016) Udhëzues për Mësuesin për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
- iii Dragoti, E., Ismaili, E. (2017) Bullizmi dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Sistemin e Arsimit të Shqipërisë. Këshilli i Evropës, 12.
- iv Ibid., 57.
- v Ibid., 104 and 14.
- vi Ibid., 32.
- vii Informacioni në këtë seksion është i bazuar në raportin Analiza e Kuadrit Ligjor dhe Institucional për Bullizmin dhe Ekstremizmin në Sistemin Arsimor Shqiptar nga Merita Poni.
- viii Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligji nr. 18/2017, datë 23.2.2017 (paragrafi 3, shkronja g).
- ix Këshilli i Evropës (2016) Kuadri Referues i Kompetencave për Kulturë Demokratike. Vëllimi 3 Udhëzime për Zbatimin, 93-94 (Qeverisja e Shkollave dhe Kultura).
- x Suckling, A. & Temple, C. (2002). Bullizmi: një qasje në nivel shkolle. Londër: Jessica Kingsley Publishers. Shih gjithashtu Smith, P.K., Pepler, D. dhe Rigby, K. (2004) Bullizmi në shkolla: Sa të suksesshme mund të jenë ndërhyrjet? Cambridge University Press.
- xi Downes, Cefai (2016), 7.
- xii <http://www.kivaprogram.net/program>
- xiii Downes, Cefai (2016) 50.
- xiv http://www.violencepreventionworks.org/public/olweus_bullying_prevention_program.page
- xv Downes, Cefai (2016), 62.
- xvi <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/albania-should-step-up-protection-of-children-and-inclusion-of-persons-with-disabilities>
- xvii ECRI (2015) RAPORTI PËR SHQIPËRINË (cikli i pestë i monitorimit) Miratuar më 19 mars 2015 <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/country-by-country/albania/ALB-CbC-V-2015-18-ENG.pdf>
Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 10 për luftimin e racizmit dhe diskriminimit racor në dhe përmes arsimit shkollor, paragrafi 47.
- xviii M. Golubeva (2017) Zgjidhjet e Politikave për Parandalimin e Bullizimit dhe Regagimi ndaj Sfidës së Ekstremizmit në Shkollat në Shqipëri. Prezantuar në konferencën e Durrësit më 29 qershor 2017.
- xix E. Bäckman, B. Trafford (2007) Qeverisja Demokratike e Shkollave. Këshilli i Europës.

MË SHUMË INFORMACION:

- ▶ **Website**
<http://horizontal-facility-eu.coe.int>
- ▶ **Facebook**
[jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)
- ▶ **Twitter**
[@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)
- ▶ **Kontaktioni**
Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë
Sheshi Skënderbej
Pallati i Kulturës
Kati i dyte,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +35544540201
Email: Horizontal.Facility@coe.int

Ky dokument është prodhuar duke përdorur fonde të një Programi të Përbashkët midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të Bashkimit Evropian ose Këshillit të Evropës.

ALB

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, 28 prej të cilëve janë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë e tyre, burimet dhe fatet. Së bashku, ato kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar të ndajë arritjet e veta, vlerat dhe popujt e vet përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe